

VENDIM
Nr. 1, datë 4.1.2018

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 187, DATË 8.3.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE CIVILË/ NËPUNËSVE, ZËVENDËSMINISTRIT DHE NËPUNËSVE TË KABINETEVE, NË KRYEMINISTRI, APARATET E MINISTRIVE TË LINJËS, ADMINISTRATËN E PRESIDENTIT, KUVENDIT, KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE, GJYKATËN E LARTË, PROKURORINË E PËRGJITHSHME, DISA INSTITUCIONE TË PAVARURA, INSTITUCIONET NË VARËSI TË KRYEMINISTRIT, INSTITUCIONET NË VARËSI TË MINISTRAVE TË LINJËS DHE ADMINISTRATËN E PREFEKTIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhja 6/7, që përmendet në pikën 9/7, të vendimit nr. 187, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të fillojnë nga data e transferimit të nëpunësve të sistemit të doganave në pozicionet e reja të punës dhe të përballohen nga fondet e miratuara për këtë sistem, për vitin 2018.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

KATEGORITË E PAGAVE DHE SHITESAT PËR KUSHTE PUNE TË PUNONJËSVE TË SISTEMIT DOGANOR

Klasifikimi doganor	Pozicioni	Kategoria	Kriteri minimal i diplomës së shkollës së lartë për efekt të pranimit në pozicionin përkatës të punës Paga e grupit	Shtesa e pozicionit	
				Shtesa e pozicionit (SHP)	Shtesa për kushte pune
	Titullar i institucionit	II-a	1		20000
	Zëvendës drejtor i përgjithshëm	II-b	1		15000
A	Drejtor Kabineti. Këshilltar. Drejtor drejtorie në Drejtorinë e Përgjithshme. Përfaqësues SELEC në DPD Kryetar i degës doganore të kategorisë A sipas përcaktimeve të Këshillit të Ministrave në vendim përkatës për personelin e administratës doganore	III-a	1		15000
B	Përgjegjës sektori në DPD Kryetar i degës doganore të kategorisë B, sipas përcaktimeve të Këshillit të Ministrave në vendim përkatës për personelin e administratës doganore Përgjegjës sektori në degët doganore të kategorisë A	III-a/1	1		14000
C1	<u>Në DPD:</u> Auditus. Specialist. Specialist laborant. Komandant Grupi Antikondrbande. Specialist QNOD. Përgjegjës zyre <u>Në degët doganore:</u> Përgjegjës zyre/turni. Specialist (analist risku, aposterior, jurist, borxhi, administrator rrjeti, financiar)	III-b	1 ose 2		14000
C2	<u>Në DPD:</u> Inspektor antikondrbande. Asistent laborant. Specialist. Specialist GFI. Doganier klasifikimi/vlerësimi/aposterior <u>Në degët doganore:</u> Specialist finance i nivelit të dytë. Doganier klasifikimi/vlerësimi/kontrolli fizik/skaner/akcizë/aposterior/regjime/preferenca/përjashtime	IV-a	1 ose 2, ose 3		10000
C3	<u>Në DPD:</u> Sekretar/protokoll. Arkivist. Përpunues informacioni. Doganier pike kontrolli <u>Në degët doganore:</u> Doganier peshoreje/pike kontrolli. Sekretar. Arkivist			40000	5000
D1	<u>Në DPD:</u> Magazinier. Teknik marinë/motorist. Teknik mirëmbajtjeje. Shofer. <u>Në degët doganore:</u> Magazinier			37000	
D2	Punëtor mirëmbajtjeje në degë doganore.			Klasa IV Sipas VKM-së për pagat e punonjësve mbështetës	
D3	Sanitar/punonjës pastrimi në DPD dhe degë doganore.			Klasa I Sipas VKM-së për pagat e punonjësve mbështetës	